



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja Nr. 37
Prishtinë, më 9.07.2010, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Dragiša Mirić, Enis Kervan, Sadik Idriz, Numan Balić, Hafize Hajdini, Hetem Arifi, Zylfi Merxha, dhe Mursel Haljilji.

Munguan: Petar Miletić, Xhevdet Neziraj dhe Rexhep Hoti.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Nga Stafi Mbështetës: Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Sanije Aliaj, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbaleve nga data 25.06.2010 dhe 5.07.2010
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Buxhet dhe Financa me amendamente
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Buxhet dhe Financa me amendamente
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Buxhet dhe Financa me amendamente
6. Shqyrtimi i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Buxhet dhe Financa me amendamente
7. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181 me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente

8. **Shqyrtimi i Projektligjit për Konfliktet Administrative me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente**
9. **Shqyrtimi i Projektligjit për Kompensimin Rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me amendamente**
10. **Shqyrtimi i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente**
11. **Të ndryshme**

1. Miratimi i rendit të ditës

Enis Kervan- Pas marrjes së informatës lidhur me mos aprovimin e programit në gjuhën turke dhe boshnjake nga Agjencia e Akreditim të Kosovës, ai tha se kjo çështje paraqet shqetësim për komunitetin tonë. Ky vendim i AAK paraqet shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Duke u bazuar në nenin 8.11 të këtij ligji, është përgjegjësi e Qeverisë së Republikës së Kosovës që të krijojë masa të veçanta për të siguruar pranimin e kandidatëve që vijnë nga shkollat e komuniteteve në institucionet e arsimit të lartë dhe universitar.

Ai kërkoi që të rekomandohet Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji që të gjejë zgjidhje për vazhdimin e regjistrimit të studentëve të rijnë për vitin akademik 2010-2011 në Fakultetin e Edukimit në Prizren - Universitetin e Prishtinës, me programet e gjuhëve boshnjake dhe turke për vazhdimin e regjistrimit të studentëve të rijnë.

Komisioni unanimisht u pajtua me kërkesën e përfaqësuesve të komuniteteve.

Kryesuesja, konstatoi që Komisioni miratoi rendin e ditës, me plotësim të propozuar nga Enis Kervan.

2. Miratimi i procesverbaleve nga data 25.06.2010 dhe 5.07.2010

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të datës 25.06.2010 dhe 5.07.2010, pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Buxhet dhe Financa me amendamente.

Pasi që nuk kishte vërejtje, **kryesuesja** konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. . Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Buxhet dhe Financa me amendamente

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë nr. 03/L-112 dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Buxhet dhe Financa me amendamente

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Buxhet dhe Financa me amendamente

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181 me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181 dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për Konfliktet Administrative me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente

Kryesuesja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Konfliktet Administrative dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara

I.

9. Shqyrtimi i Projektligjit për Kompensimin Rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me amendamente

Kryesuesja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Kompensimin Rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara

10. Shqyrtimi i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente

Kryesuesja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara

11. Të ndryshme

Kryesuesja – konstatoi se Komisionin miratoi kërkesën e Hafize Hajdinit, lidhur me projektin e Dubravës, për ndërtim të disa shtëpive në Ferizaj dhe pas konsultimeve të bazuara në këtë kërkesë, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mbledhjen e mbajtur me 9.07.2010, murr qëndrim që në mbledhje të radhës të ftojë Ministrin për Komunitete dhe Kthim, dhe Ministrinë për Punë e Mirëqenie Sociale, që të ofrojnë sqarim lidhur me zhvillimet rreth ndërtimit të 44 shtëpive në Ferizaj.

Mbledhja përfundoi në orën 12:35

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetarja e parë Komisionit

Saniye Aliaj